

RREGULLORE

“PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTIT NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”

Në zbatim të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 13/d, 14/1, 14/2, 14/3 dhe 69/4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit miraton këtë rregullore për procedurat që ndiqen për organizimin e shortit gjatë veprimtarisë së këtij institucioni.

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt:

- a) Procedurat e shortit për ndarjen e trupave gjyquese;
- b) Procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues;
- c) Procedurat e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjyquese, si dhe caktimin e anëtarit relator.

Neni 2

Parimet

Kjo rregullore bazohet në parimin e transparencës, barazisë, efikasitetit, efijencës dhe objektivitetit, si dhe garanton ndarje të barabartë çështjesh midis komisionerëve.

Neni 3

Rregulla të përgjithshme

1. Procedurat e shortit, sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje, realizohen në prani të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Kryetari i Komisionit drejton procedurën e shortit me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm, dhe në mungesë të tij, nga një punonjës i autorizuar nga Kryetari i Komisionit.
3. Për çdo rast të organizimit të shortit, Kryetari i Komisionit, njofton me shkrim ose me e-mail të gjithë komisionerët, jo më vonë se dy ditë pune përpara datës së hedhjes së shortit. Njoftimi përmban datën, orën dhe sallën e zhvillimit të shortit.
4. Në çdo rast të hedhjes së shortit, Komisioni, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, njofton me shkrim dhe fton të marrin pjesë me cilësinë e vëzhguesit, anëtarët e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

5. Procedurat për hedhjen e shortit zhvillohen në mjediset e punës ku zhvillon veprimtarinë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
6. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, procedurat e shortit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të mbahen në datat e mëposhtme:
 - a) 15 dhjetor 2019;
 - b) 15 qershor 2020;
 - c) 15 dhjetor 2020;
 - d) 15 qershor 2021.

Në rast se data 15 është ditë pushimi, shorti zhvillohet në ditën e parë pasardhëse të punës.

7. Përveç shortit të organizuar sipas pikës 6 më sipër, Komisioni organizon short të veçantë dhe të posaçëm brenda 30 ditëve nga marrja dijani zyrtarisht për kandidimin, për:
 - a) Subjektet e rivlerësimit të përcaktuar në listën e përparësive për shkak të ligjit;
 - b) Subjektet e rivlerësimit, të cilët, edhe pse nuk bëjnë pjesë në listën e përparësive për shkak të ligjit, kanë përparësi për shkak të statusit si kandidatë për t'u përzgjedhur në Gjykatën Kushtetuese, institucionet e lidhura të SPAK-ut, të KLGJ-së, KLP-së ose KED-së, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokurorit të Përgjithshëm, etj.
8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen procedurat për organizimin e një shorti të veçantë dhe të posaçëm, pas rekomandimit me shkrim të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi.
9. Lista nominale e subjekteve të rivlerësimit, si dhe data e shortit të veçantë e të posaçëm, sipas pikës 7 dhe 8 të këtij neni, përcaktohet paraprakisht me vendimin e mbledhjes së Komisionit, të paktën 3 (tri) ditë përpara datës së hedhjes së shortit.
10. Lista e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohet shortit, për çdo rast, publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, ditën pasardhëse të punës, pas hedhjes së shortit.
11. Kërkesat për dorëheqje të paraqitura nga subjektet e rivlerësimit, të cilët nuk janë shortuar, si dhe përfundimi i procedurave të rivlerësimit për subjektet që kanë mbushur moshën për pension përpara se të bëhen pjesë e procedurave të shortimit nga Komisioni, shqyrtohen nga një trup gjykues i zgjedhur me short për një periudhë njëvjeçare, në përputhje me vendimin e Komisionit nr.15, datë 7.3.2018, duke filluar nga data 8.3.2018.
12. Të gjitha procedurat e shortit, për çdo rast, evidentohen në procesverbalin që mbahet nga sekretari i Kryetarit të Komisionit dhe nënshkruhet nga të gjithë komisionerët e pranishëm. Në mungesë të sekretarit, procesverbali mbahet nga një person i autorizuar nga Kryetari i Komisionit.

Neni 4

Procedurat e shortit për ndarjen e trupave gjyqesore

1. Komisioni organizohet në katër trupa gjyqesore, të përbërë nga tre anëtarë. Çdo trup gjyqesor përbëhet nga relatori dhe dy anëtarë. Kryesuesi zgjidhet midis dy anëtarëve të tjerë me dakordësi në mbledhjen e parë të trupit gjyqesor. Në rast se nuk arrihet mirëkuptimi, kryesuesi zgjidhet me short nga anëtarët e trupit gjyqesor.
2. Përpara fillimit të procedurave të shortit, emrat e të gjithë anëtarëve të Komisionit shkruhen në shirita të barabartë letre, me germë *arial 12*, verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit të emrave nga Kryetari i Komisionit, i cili, pas verifikimit, i palos në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë të paktën nga tre komisionerë, përveç Kryetarit, për të verifikuar njëtrajshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe temperaturë. Pas këtij verifikimi, Kryetari i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përzie, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
3. Kryetari, me cilësinë e drejtuesit të shortit, përzgjedh në mënyrë rastësore tri gogla nga kutia transparente. Pasi i hap goglat një e nga një, lexon me zë të lartë emrat e tre komisionerëve, të cilët përbëjnë trupin e parë gjyqesor.
4. E njëjta procedurë, me të njëjtën radhë veprimesh, kryhet edhe për përcaktimin e tri trupave të tjera gjyqesore.
5. Në përfundim të kësaj faze të hedhjes së shortit, Kryetari lexon edhe një herë me zë të lartë emrat e anëtarëve të çdo trupi gjyqesor.

Neni 5

Procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues

1. Anëtari zëvendësues përcaktohet me short për çdo trup gjyqesor, duke filluar nga trupi i pari gjyqesor i përzgjedhur, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.
2. Procedura e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues zhvillohet njësoj si procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të trupit gjyqesor.
3. Në përfundim të të gjithë kësaj procedure, Kryetari lexon me zë të lartë edhe një herë emrat e anëtarëve zëvendësues për çdo trup gjyqesor.

Neni 6

Procedurat e shortit për shpërndarjen e çështjeve të anëtarit relator

1. Shpërndarja e barabartë dhe rastësore e çështjeve në trupa gjyqesore sigurohet nëpërmjet caktimit me short të anëtarit relator.
2. Çdo komisioner asistohet në mënyrë të përhershme nga një këshilltar ligjor, një këshilltar ekonomik, si dhe një sekretare gjyqësore.

3. Të gjithë komisionerët do të jenë anëtarë relatorë në numër të barabartë çështjesh. Në këtë mënyrë, sigurohet barazia e ndarjes së çështjeve edhe ndërmjet trupave gjyquese.
4. Ndarja e çështjeve sipas anëtarit relator, në shortet që do të zhvillohen sipas pikës 6 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, do të jetë 10 çështje për çdo relator në procedurë shorti.
5. Ndarja e çështjeve sipas anëtarit relator, në shortet që do të zhvillohen sipas pikës 7 dhe 8 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, do të përcaktohet me vendim të Komisionit, sipas pikës 9 të nenit 3 të kësaj rregulloreje.
6. Numri i subjekteve që do të shortohen sipas germës “a”, “b” dhe “c”, pikës 6 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, është 120, nga të cilët, 60 gjyqtarë dhe 60 prokurorë. Në shortin e organizuar sipas germës “d” të pikës 6 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, do të shortohen të gjithë subjektet e mbetur pa shortuar.
7. Kryetari i Komisionit, pasi lexon emrat e subjekteve gjyqtarë, të shkruar në shirita të barabartë letre, me germë arial 12, me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm, palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kuti, preken me dorë të paktën nga tre komisionerë për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe temperaturë. Më tej ato do të vendosen në dy kuti të ndryshme transparente, në njërin subjektet e rivlerësimit që ushtrojnë funksionin në Tiranë dhe në tjetrën subjektet e rivlerësimit që ushtrojnë funksionin në rrethe.
8. Të paktën, tre komisionerë do të jenë të pranishëm gjatë përgatitjes së goglave. Pas procedurës së verifikimit, goglat vendosen në kutinë transparente dhe përzihen, në mënyrë që të garantohet barazia në përzgjedhje.
9. Goglat me emrat e gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në Tiranë, përgjithësisht të parat. Çdo komisioner, sipas rendit alfabetik, përzgjedh gogllën përkatëse, derisa të plotësohet numri 30. Përzgjedhja vazhdon me kutinë që përmban emrat e gjyqtarëve në rrethe të tjera, me të njëjtën procedurë, derisa të plotësohet numri 30.
10. E njëjta procedurë ndiqet në përzgjedhjen e prokurorëve, dhe në fund të kësaj procedure, përzgjidhen 60 prokurorë, nga të cilët, 30 që ushtrojnë funksionin në Tiranë, dhe 30 të tjerë në rrethe.
11. Në rast të një procedure të veçantë dhe të posaçme, goglat vendosen në një kuti të vetme transparente. Përzgjedhja kryhet me radhë nga komisionerët, në rend afalbetik, deri në përfundim të listës së subjekteve të rivlerësimit të miratuar me vendimin përkatës së Komisionit.
12. Në çdo short të organizuar, Kryetari lexon me zë të lartë emrin e subjektit të rivlerësimit që gjendet në gogël. Ky emër, pasi regjistrohet në procesverbal, korrespondohet me emrin përkatës të relatorit të çështjes.
13. Në mungesë të ndonjë anëtari të Komisionit, tërheqja e goglave, në emër të tij, do të bëhet nga Kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
14. Në rast zëvendësimi të relatorit, anëtarit zëvendësues të cilit i caktohet çështja, do të tërheqë më pak çështje në cilësinë e relatorit në shortin e radhës. Anëtarit relator të zëvendësuar, në shortin e radhës do t’i caktohen çështjet përkatëse në vend të anëtarit/komisionerit zëvendësues, për aq çështje sa është zëvendësuar. Ky rregull zbatohet për çdo zëvendësim

të relatorit të çështjes. Lista e zëvendësimeve do të përgatitet nga Sekretari i Përgjithshëm përpara organizimit të çdo shorti.

15. Në përfundim të kësaj procedure, pasi janë hapur të gjithë goglat, Kryetari lexon edhe një herë me zë të lartë emrat e subjekteve të rivlerësimit të shortuar dhe relatorëve përkatës. Goglat dhe shiritat e letrave të përdorur në këtë fazë të shortit, administrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, duke u përjashtuar nga shortimi i mëtejshëm.
16. Sekretari i Përgjithshëm kujdeset për sigurimin e kushteve të njëjta në çdo procedurë të hedhjes së shortit, sipas këtij neni.
17. E gjithë procedura sipas këtij neni, pasqyrohet në procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm gjatë hedhjes së shortit.
18. Pas përfundimit të çdo shorti, secili prej subjekteve të rivlerësimit identifikohet me numër rendor në regjistrin e dosjeve që administrohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 7

Dispozita përfundimtare

1. Ky akt ndryshohet më vendim të Mbledhjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Rregullorja e miratuar me vendimin nr.10, të datës 04.11.2017 dhe ndryshimet përkatëse, do të shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.
3. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin nga mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Miratuar me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019 të mbledhjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.